## Dhjetë parimet e vlerësimit efektiv të hapësirave ligjore për korrupsion...

Parimi 1: Fusha e veprimit
Parimi 2: Vendosja e prioriteteve
Parimi 3: Risqet për korrupsion në aktet rregullatore
Parimi 4: Afati kohor
Parimi 5: Institucioni përgjegjës
Parimi 6: Rekomandimet
Parimi 7: Përputhshmëria
Parimi 8: Publiciteti në Internet
Parimi 9: Kuadër më i gjerë për transparencën dhe integritetin
Parimi 10: Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i publikut

## Qasja parlamentare ndaj korrupsionit:

Në Shqipëri, ashtu si dhe në demokracitë e tjera kushtetuese, hartimi i legjislacionit ose procesi i ligjbërjes konsiderohet si një atribut thelbësor i "sovranitetit të Parlamentit", që njihet ndryshe edhe si "supremacia legjislative". Mënyra e miratimit të legjislacionit është e rëndësishme nga pikëpamja e legjitimitetit si të legjislacionit ashtu edhe të vetë legjislativit që e miraton. Aktorët me legjitimitet të fortë kanë një pozicion më të mirë nga i cili mund të luftojnë korrupsionin dhe të gëzojnë besimin e publikut. Anëtarët e Parlamentit duhet të shmangin vendosjen e tyre në rolin e "noterit" të vullnetit të ekzekutivit. Zgjedhësit duan të shohin deputetët e tyre duke shqyrtuar çdo projekt-ligj para tyre. Gjatë shqyrtimit të projekt-ligjeve në komisionet e Parlamentit (faza e komisioneve) ata duhet të advokojnë për ushtrimin e të drejtës së qytetarëve "për t'u konsultuar, ftuar dhe kërkuar mendimet e ekspertëve, ministrive dhe zyrave përkatëse shtetërore, publikut dhe palëve të tjera të interesuara. Në këtë mënyrë Parlamenti mund të ndikojë në veprimtarinë e ekzekutivit, dhe kështu ekzekutivi do të mësohet të angazhohet dhe të negociojë veprime politike transformuese.

## Opinioni për vërtetimin e korrupsionit përmban:

- Rreziqet e korrupsionit në procesin legjislativ
- Faktorët e rrezikut dhe rreziqet e korrupsionit në draft-aktin/aktet e shqyrtuar(a)
- Konkluzione

### Aspektet kryesore për anëtarët e Parlamentit kur shqyrtohet një **projekt-ligj**

- kush do të përfitojë më shumë nga zbatimit i ligjit në të ardhmen;
- nëse ka grupe brenda shoqërisë (për shembull, grupe të margjinalizuara) mbi të cilët projekt-ligji do të ketë një ndikim negativ afatgjatë;
- nëse projekt-ligji përmban dispozita që krijojnë kompetenca diskrecionale për zyrtarët;
- nëse projekt-ligji përmban dispozita dhe terma të paqarta ose abstraktë;
- nëse, në përgjithësi, ligji ofron më pak transparencë dhe llogaridhënie.

### Listë kontrolli për vlerësimin e hapësirave për Korrupsion

**A — DYKUPTUESHMËRIA**
- A1. **Stili gjuhësor**
- A2. **Harmonizimi**

**B — RREZIQET SUBSTANCIALE**
- B1. **Objektivat e ligjit/aktit nënligjor**
- B2. **Procedurat**
- B3. **Organi zbatues**
- B4. **Mbikëqyrja**
- B5. **Sanksionet**
- B6. **Kontrolli gjyqësor**

ACER
Albanian Center for Economic Research



# PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE

British Embassy
Tirana

WFD

## Ç'kuptojmë me Vlerësim të Legjislacionit për Parandalimin e Korrupsionit?

Vlerësimi kundër korrupsionit i legjislacionit ose ndryshe "testimi i korrupsionit" është një rishikim i formës dhe substancës së rregullave ligjore të hartuara ose të miratuara me qëllim zbulimin dhe minimizimin e rrezikut të korrupsionit në të ardhmen që rregullat mund ta lehtësojnë atë.
Vlerësimi i legjislacionit synon të identifikojë rreziqet e korrupsionit në projekt-ligjet dhe aktet nënligjore dhe faktorët që i gjenerojnë ato dhe të paraqesë rekomandime për shmangjen e tyre.

## Qëllimi i testimit anti-korrupsion të projekt-akteve ligjore:

- Parandalimi i korrupsionit duke eliminuar faktorët e rrezikut të korrupsionit nga projekt-ligjet;
- Ndërgjegjësimi i autorëve të projekt-ligjeve dhe publikut të gjerë për faktorët e rrezikut dhe rreziqet e korrupsionit të identifikuara në drafte, dhe
- Sigurimi i masave mbrojtëse shtesë për të garantuar që procesi legjislativ shtyn përpara interesat e qytetarëve dhe motivohet nga mbrojtja e interesit publik.

*Testimi kundër korrupsionit (ekspertiza kundër korrupsionit e projekt-ligjeve) - një proces shqyrtimi i projekt-ligjeve dhe akteve nënligjore, që synon zbulimin e dispozitave që favorizojnë ose legalizojnë korrupsionin dhe abuzimet e tjera ne procesin e zbatimit te tyre.*

UKaid from the British people

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

## Çfarë veçorish ka vlerësimi anti-korrupsion i kuadrit ligjor?

Fushë-veprimi:
- mund të përfshijë të gjitha projekt-ligjet dhe legjislacionin sekondar në zbatim të tyre.

Institucioni përgjegjës për korrigjimin e detyrueshëm të legjislacionit:
- institucioni/dikasteri propozues edhe/ose Parlamenti për aktet që miraton ky institucion.

Koha e Vlerësimit anti-korrupsion:
- pasi drafti të jetë përfundimtar i paraqitur nga qeveria, ose kur të dorëzohet nga institucioni propozues/një deputet, para se të dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë për opinion/ekspertizë juridike, si dhe përpara shqyrtimit në komisionet përgjegjëse të Parlamentit.

Afati i zakonshëm i shqyrtimit:
- sipas procedurës ligjore të Parlamentit, rekomandohet jo më pak se 10 ditë deri në 1 muaj për testimin anti-korrupsion.

Metodologjia e Vlerësimit:
- e shkruar edhe/ose softuerike, e përditësuar me asistencën e huaj.

## Rreziqet e integritetit të ndeshura përgjatë ciklit të prokurimit publik

| | | |
|---|---|---|
| Faza para tenderimit | Vlerësimi i nevojave dhe analiza e tregut | • Vlerësimi jo adekuat i nevojave<br>• Ndikimi i aktorëve të jashtëm në vendimet e zyrtarëve<br>• Marrëveshje për kontrata në mënyrë jo formale |
| | Planifikimi dhe buxhetimi | • Planifikimi i dobët i prokurimit<br>• Prokurim jo në përputhje me procesin e përgjithshëm të vendimmarrjes për investime<br>• Buxhetim jo realist ose mangësi në buxhet |
| | Zhvillimi i specifikimeve/kërkesave | • Specifikimet teknike të përshtatura për një kompani specifike<br>• Kriteret e përzgjedhjes nuk janë të përcaktuara objektivisht dhe nuk janë përcaktuar paraprakisht<br>• Kërkimi i mostrave të panevojshme të mallrave dhe shërbimeve<br>• Blerja e informacionit mbi specifikimet e projektit. |
| | Zgjedhja e procedurës së prokurimit | • Mungesa e justifikimit të duhur për përdorimin e procedurave jokonkurruese<br>• Abuzimi i procedurave jokonkurruese në bazë të përjashtimeve ligjore: ndarje e kontratës, shpërdorim i kontigjencës, modifikime të pambështetura |
| Faza e tenderimit | Kërkesë për propozim/ofertë | • Mungesa e njoftimit publik për ftesën për ofertë<br>• Mos shpallja e kritereve të vlerësimit dhe dhënies<br>• Informacioni i prokurimit nuk zbulohet dhe nuk bëhet publik |
| | Dorëzimi i ofertës | • Mungesa e konkurrencës ose rastet e ofertave të fshehta (ofertimi mbulues, shtypja e ofertës, rotacioni i ofertave, shpërndarja e tregut) |
| | Vlerësimi i ofertës | • Konflikti i interesit dhe korrupsioni në procesin e vlerësimit nëpërmjet: Njohjeve personale me ofertuesit<br>• Interesat personale si dhuratat ose punësimi i ardhshëm/shtesë: Nuk ka zbatim efektiv të "parimit të katër syve" |
| | Dhënia e kontratës | • Shitësit dështojnë të zbulojnë të dhëna të sakta të kostos ose çmimeve në propozimet e tyre të çmimeve, duke rezultuar në një çmim të rritur të kontratës (p.sh. shënjimi i faturave (invoice mark-up), mbushja e kanaleve (channel stuffing)<br>• Konflikti i interesit dhe korrupsioni në procesin e miratimit (d.m.th. asnjë ndarje efektive e autoriteteve financiare, kontraktuale dhe të projektit)<br>• Mungesa e aksesit në të dhënat mbi procedurën |
| Faza pas lidhjes së kontratës | Menaxhimi/performanca e kontratës | Abuzimet e ofruesit në zbatimin e kontratës, veçanërisht në lidhje me cilësinë, çmimin dhe kohën e saj:<br>- Ndryshim thelbësor në kushtet e kontratës për të lejuar më shumë kohë dhe/ose çmime më të larta për ofruesin<br>- Zëvendësimi i produktit ose punës/shërbimit nën standardet që nuk plotësojnë specifikimet e kontratës<br>- Vjedhja e aseteve të reja përpara dorëzimit te përdoruesi fundor ose para se të regjistrohen<br>- Mbikëqyrje e dobët nga zyrtarët publikë dhe/ose marrëveshje të fshehta ndërmjet kontraktorëve dhe zyrtarëve mbikëqyrës<br>- Nënkontraktorët dhe partnerët e zgjedhur në mënyrë jo transparente ose jo të përgjegjshme |
| | Porosia dhe pagesa | Ndarja e paplotë e detyrave financiare dhe/ose mungesa e mbikëqyrjes së zyrtarëve publikë që çon në:<br>- Kontabilitet i pasaktë dhe shpërndarje e gabuar e kostos ose migrimi i kostos ndërmjet kontratave<br>- Faturime të rreme ose të dyfishta për mallra dhe shërbime të pafurnizuara dhe për pagesa të përkohshme në të drejtën e paradhënies |

https://www.oecd.org/gov/ethics/Corruption-Public-Procurement-Brochure.pdf